

ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR NUMRI 110 | dhjetor 2017



Takim i përbashkët midis drejtuesve të lartë të autoriteteve mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe Kosovës për ecurinë e tregut të sigurimeve

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2017

Zhvillime të tjera

- AMF dhe Kolegji Universitar “Luarasi”, bashkëpunim për të rritur edukimin financiar tek studentët
- AMF thëllon bashkëpunimin me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare
- AMF në bashkëpunim me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë fillojnë projektin për mikro-sigurimet vullnetare
- Zhvillohet mbledhja e parë e autoriteteve të tregjeve të kapitalit të Ballkanit Perëndimor “Diversifikimi i Sistemeve Financiare, një mënyrë për të nxitur investimet”
- Zhvillohet takimi i 14-të i Iniciativës së Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve

Edukimi i Konsumatorit

- Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim i rëndësishëm (Pjesa e dytë)

Lajme Ndërkombëtare

- Bosnje-Hercegovinë ○ Çeki ○ Greqi ○ Hungari ○ Mali i Zi ○ Maqedoni ○ Poloni ○ Serbi ○ Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis autoriteteve rregullatore në tregun e sigurimeve të të dy vendeve si mundësi shumë e mirë e zgjerimit dhe forcimit të tregut të sigurimeve.



Takim i përbashkët midis drejtuesve të lartë të autoriteteve mbikëqyrëse të Shqipërisë dhe Kosovës për ecurinë e tregut të sigurimeve



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së Z. Ervin Koçi dhe zyrtarë të lartë të AMF-së në takimin me përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës

Në kuadër të bashkëpunimit midis autoriteteve mbikëqyrëse e rregullatore të tregut të sigurimeve të Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, një delegacion nga Banka Qendrore e Kosovës dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve zhvilloi në datë 22 dhjetor, një takim pune pranë zyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së Z. Ervin Koçi duke mirëpritur dhe drejtuar këtë takim, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit midis autoriteteve rregullatore në tregun e sigurimeve të të dy vendeve si mundësi shumë e mirë e zgjerimit dhe forcimit të tregut të sigurimeve. Në këtë takim ishin të pranishëm drejtuesit ekzekutivë të shoqërive shqiptare të sigurimit, të cilat e kanë shtrirë aktivitetin e tyre edhe në Kosovë si Z. Avni Ponari, Sigal Uniqa Group Austria, Z. Klaidi Çitozi, Sigma Inter Albanian Viena Insurance Group, Z. Dritan Çelaj, Atlantik – Shoqëri Sigurimesh, si edhe drejtori i Byrosë Shqiptare të Sigurimeve Z. Kevin Lleshi. Delegacioni nga Kosova përbëhej nga drejtori i departamentit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, pranë Bankës Qendrore të Kosovës Z. Nexhat Miftari si edhe drejtuesi i Byrosë Kosovare të Sigurimeve.

Takimi lidhej me diskutimin e disa çështjeve specifike për tregun e sigurimeve dhe byrotë e sigurimeve përkatëse, në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar në vitin 2004 nga të dy institucionet. Synimi i takimit ishte forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit midis dy institucioneve, në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve respektive.

Gjatë takimit përfaqësuesit e Byrosë Shqiptare dhe asaj Kosovare të sigurimeve diskutuan edhe për problematikat e dy tregjeve, si për pagesat e dëmeve dhe u trajtuan edhe detaje teknike për mënyrën e organizmit të këtyre pagesave.

Në përfundim të takimit u ra dakord të bëhet rakordimi i plotë midis të dy Byrove të Sigurimeve për detyrimet dhe pagesat e dëmeve brenda një afati të shkurt kohor. Gjithashtu do të fillojë puna për hartimin e një marrëveshje të re, specifike për bashkëpunim e mëtejshëm midis të dy institucioneve.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi theksoi gatishmërinë e AMF-së për të nxitur këtë bashkëpunim, shkëmbim të informacionit dhe përvojave teknike e profesionale midis institucioneve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar–nëntor 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-nëntor 2017 kapën vlerën mbi 14.29 miliardë lekë, ose 6.85% më shumë se gjatë periudhës janar-nëntor 2016. Gjatë periudhës janar-nëntor 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,136,689 me një rritje prej 14.04% krahasuar me periudhën janar-nëntor 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistrojnë një rritje me 15.80% në krahasim me periudhën janar-nëntor 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 4.36 miliardë lekë, apo 16.39% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 7.15% gjatë periudhës janar-nëntor 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-nëntor 2016.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 8.88 miliardë lekë gjatë periudhës janar-nëntor 2017, duke shënuar një rritje prej 6.89% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.15% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

■ Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 10.86% të tregut të Jo-Jetës;

■ Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 13.11% të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rriten me 28.16% krahasuar me periudhën janar- nëntor 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitor” e cila përbën 64.83% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 8.88 miliardë lekë gjatë periudhës janar-nëntor 2017, duke shënuar një rritje prej 6.89% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-nëntor 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

AMF dhe Kolegji Universitar “Luarasi”, bashkëpunim për të rritur edukimin financiar tek studentët



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i Kolegjit Universitar “Luarasi”, Prof. Dr. Et'hem Ruka gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se iniciativa e nisur për edukimin financiar me studentët e pedagogët, do të zgjerohet edhe me grupe të tjera për të përcjellë informacione të thjeshta e të kuptueshme për gjithë publikun.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në 18 dhjetor një takim informues me studentët e Kolegjit Universitar “Luarasi”, në vijim të zbatimit të Strategjisë për “Rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”. Aktiviteti synoi rritjen e njohurive dhe edukimin financiar të të rinjve për Autoritetin. Gjatë aktivitetit u nënshkrua edhe një marrëveshje bashkëpunimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Kolegjit Universitar “Luarasi”, nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i Kolegjit Universitar “Luarasi”, Prof. Dr. Et'hem Ruka.

Në fillim të fjalës së rastit, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi, pasi shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin me Kolegjin Universitar “Luarasi”, bëri një përshkrim të shkurtër në lidhje me financimin dhe funksionimin e Autoritetit, duke theksuar se “Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është krijuar mbi bazën e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare" dhe është një person juridik publik i pavarur që raporton në Kuvendin e Shqipërisë”.

Më tej, Z. Koçi theksoi se rritja e njohurive financiare është mjete më i mirë për të mbrojtur qytetarët dhe për t'i larguar ata nga abuzimet. “Eksperienca jonë e viteve të kaluara me skema financiare të gabuara, por edhe eksperienca të ngjashme botërore kanë treguar sa i rëndësishëm është një konsumator me edukim financiar të mjaftueshëm, por edhe në vazhdimësi.”

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së theksoi se iniciativa e nisur për edukimin financiar me studentët e pedagogët, do të zgjerohet edhe me grupe të tjera për të përcjellë informacione të thjeshta e të kuptueshme për gjithë publikun. Në funksion të mbrojtjes së konsumatorit, Autoriteti është duke punuar për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për tregjet nën mbikëqyrje. Për këtë, ai po bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë si

Banka Botërore dhe ka si synim kryesor t'i japë zgjidhje problemeve të hasura deri tani në tregjet nën mbikëqyrje.

Me interes u pritën pyetjet nga pedagogët dhe studentët të Kolegjit Universitar "Luarasi" lidhur edhe me funksionet dhe organizimin e Autoritetit. Duke iu përgjigjur pyetjeve specifike, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së shpjegoi se bazuar në ligjin për AMF-në, Autoriteti financohet nga tregjet nën mbikëqyrje, nuk merr para nga buxheti i shtetit dhe synon rregullimin e tregjeve financiare jo bankare, duke mbrojtur njëkohësisht interesat e konsumatorëve dhe nxitur qëndrueshmërinë, transparencën dhe besueshmërinë.

Nga ana e tij, rektori i Kolegjit Universitar "Luarasi", Z. Et'hem Ruka nënvizoi se marrëveshja e bashkëpunimit me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare do t'u shërbejë dy institucioneve për shkëmbim eksperiencash, por edhe si një urë lidhëse për studentët, edhe për shkak të Masterit profesional për "Menaxhim sigurimesh" të nisur këtë vit akademik nga Kolegji Universitar "Luarasi". Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare synon ta vijojë fushatën e edukimit financiar vitin e ardhshëm me takime të tjera në universitete, por edhe grupe të tjera interesi.

AMF thellon bashkëpunimin me Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së dhe drejtues të tjerë gjatë takimit me përfaqësues të Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare, FSVC-së

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe drejtues të tjerë të AMF-së zhvilluan sot, më 12 dhjetor 2017 një takim me përfaqësues të Korpusin Vullnetar të Shërbimeve Financiare, FSVC-së, Z. Charles E. Kilbourne, menaxher në zyrat qendrore dhe Z. Ersion Kotini, drejtori lokal i FSCV-së në Shqipëri.

Objekti i takimit ishte thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe iniciimi i projekteve të përbashkëta midis dy institucioneve. Gjatë vitit 2017, AMF dhe FSVC kanë thelluar bashkëpunimin duke vijuar me projektin e sistemit të paralajmërimit të hershëm që shërben si bazë për mbikëqyrjen në tregun e sigurimeve. Duke falënderuar për asistencën e dhënë deri tani, z. Ervin Koçi, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, theksoi se projektet e deritanishme

Z. Ervin Koçi, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, theksoi se projektet e deritanishme kanë kontribuar në zhvillimin profesional dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së.

kanë kontribuar në zhvillimin profesional dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së. Përfaqësuesit e FSVC theksuan bashkëpunimin e suksesshëm në disa projekte në mbështetje të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të AMF-së, duke veçuar programin trajnues afatgjatë për aktuarët deri në pajisjen e tyre me certifikatë. (*Actuarial Training and Certification Program, ATCP*) si edhe asistencën në hartimin e ligjeve për fondet e investimeve dhe të pensioneve private.

Autoriteti është i motivuar të zhvillojë tregun e sigurimeve gjithëpërfshirëse dhe të krijojë njohuri për një eksperiencë afatgjatë lidhur me mikro-sigurimet bazuar në standardet ndërkombëtare të sigurimeve. Për këto arsye, theksoi Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, z. Koçi, AMF kërkon edhe bashkëpunim me FSVC për të na ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e aksesit në mikro-sigurime për popullsinë me të ardhura të ulëta në vend. Përfaqësuesit e FSVC-së u shprehën të gatshëm për thellimin e bashkëpunimit me Autoritetin duke rritur edhe numrin e projekteve të përbashkëta.

AMF në bashkëpunim me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë fillojnë projektin për mikro-sigurimet vullnetare



Drejtues të lartë të AMF-së së bashku me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë gjatë prezantimit të projektit për sigurimin vullnetar gjithëpërfshirës në vend.

Z. Koçi, theksoi:
“AMF kërkon edhe bashkëpunim me FSVC për të na ndihmuar në zhvillimin dhe përmirësimin e aksesit në mikro-sigurime për popullsinë me të ardhura të ulëta në vend.”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare së bashku me disa partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë filluan më 4 dhjetor, projektin për sigurimin vullnetar gjithëpërfshirës në vend. Ky projekt mbështetet dhe financohet nga Iniciativa për Akses në Sigurime (*Access to Insurance Initiative*) në bashkëpunim me Akademinë për Udhëheqje Globale të GIZ (*GIZ Global Leadership Academy*). AMF e fitoi këtë projekt pas një procesi aplikimi dhe përzgjedhjeje që filloi në maj të këtij viti. Projekti do të zgjasë deri në nëntor 2018.

Si pjesë e këtij projekti është krijimi i një ekipi kombëtar, i cili do të punojë për të adresuar në një mënyrë të re sfidat me të cilat përballlet industria e sigurimeve në vend lidhur me mikro-sigurimet, si sigurime vullnetare gjithëpërfshirëse. Pjesëmarrës në këtë ekip janë drejtues departamentesh të rëndësishme nga shoqëritë e sigurimit, banka, agjenci kreditimi si edhe organizma të tjerë që kanë aktivitet në fushën financiare dhe të biznesit. AMF është pjesë e këtij ekipi e përfaqësuar nga Nëndrejtoresha Ekzekutive, Znj. Mimoza Kaçi.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi "... ky projekt do të jetë një përvojë e mirë në diskutimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për kapërcimin e barrierave të kostove të produkteve dhe futjen e produkteve të reja të përshtatshme për pjesën me të ardhura të ulëta të shoqërisë, duke rritur përfshirjen e popullsisë në skema të ndryshme të mikro-sigurimesh vullnetare."

Në *workshopin* e parë prezantues të këtij projekti, përshëndeti Z. Hans-Jürgen Cassens, Drejtuesi Rajonal i GIZ në Shqipëri, i cili theksoi potencialin e madh që ka mikro-sigurimi në vend, duke bashkuar të gjithë aktorët e interesuar për të sjellë zgjidhje inovative. Duke theksuar rëndësinë e këtij projekti për Shqipërinë, Z. Ervin Koçi, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së bëri edhe një pasqyrë të ecurisë së tregut të sigurimeve në vend duke nënvizuar shkallën e ulët të penetrimit të produkteve të sigurimit në Shqipëri, si më e ulëta në rajon. Ai theksoi se një nga arsyt kryesore të aplikimit për këtë projekt është se vendi ynë me një ekonomi në zhvillim, ka pjesëmarrje mjaft të ulët në sigurime, dhe kjo sidomos për individët me të ardhura të ulëta dhe bizneset e vogla e të mesme (SME). Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv theksoi "... ky projekt do të jetë një përvojë e mirë në diskutimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për kapërcimin e barrierave të kostove të produkteve dhe futjen e produkteve të reja të përshtatshme për pjesën me të ardhura të ulëta të shoqërisë, duke rritur përfshirjen e popullsisë në skema të ndryshme të mikro-sigurimesh vullnetare."

Ekipi kombëtar do të punojë në disa faza për ndërtimin e besimit dhe lidhjeve bashkëpunuese për mikro-sigurimet, kuptimin e saktë të realitetit dhe mundësive për sigurime gjithëpërfshirëse në vend, krijimin e dialogun për mikro-sigurimet vullnetare dhe gjetjen e rrugëve inovative për përballimin e sfidave në këtë sektor. Objektivi përfundimtar është rritja e pjesëmarrjes së individëve dhe bizneseve në skema sigurimesh vullnetare gjithëpërfshirëse.

Zhvillohet mbledhja e parë e autoriteteve të tregjeve të kapitalit të Ballkanit Perëndimor "Diversifikimi i Sistemeve Financiare, një mënyrë për të nxitur investimet"

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) organizoi takimin e parë të Autoriteteve të Tregut të Kapitalit të Gjashtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) "Diversifikimi i sistemeve financiare për të rritur investimet", në Vjenë, Austri më 19 dhjetor 2017. Ky takim ishte në përputhje me aktivitetet për zbatimin e Planit Shumëvjeçar të Veprimit (MAP) për Zonën Ekonomike Rajonale (REA) të Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal (RCC).

Sipas Planit Shumëvjeçar të Veprimit (MAP), synohet mbështetja e integrimin të tregjeve financiare në rajon. Takimi synoi edhe fillimin e një platforme rajonale për integrimin e tregjeve financiare në Evropën Juglindore (SEE) e cila do të identifikojë nevojat për zhvillimin e tregjeve të kapitalit bazuar në iniciativat ekzistuese dhe analizës dhe reformës. Takimi shqyrtoi gjithashtu edhe mundësitë për integrim të gjerë të tregjeve të kapitalit dhe duke vlerësuar edhe nevojën për një strategji rajonale për zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Në takim ishin përfaqësues të autoriteteve të Ballkanit Perëndimor përgjegjës për tregjet financiare, si ministritë e financave, komisionet e letrave me vlerë dhe bursat, partnerët ndërkombëtarë si Banka Botërore, Iniciativa e Vjenës, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), SEE Link, Konferenca e

Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD), dhe Komisioni Evropian. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga vendet si Mali i Zi, Shqipëria, Bosnjë Hercegovina, Republika e Kosovës, Maqedonia dhe Republika e Serbisë. Përfaqësuesi i Shqipërisë bëri një prezantim mbi zhvillimin e tregjeve të kapitalit në Shqipëri dhe sfidat me të cilat përballet ato.

Zhvillohet takimi i 14-të i Iniciativës së Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve

Në Zagreb, Kroaci, u zhvillua në datat 5-6 dhjetor 2017 takimi i 14-të i Iniciativës së Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore për Mbikëqyrjen e Sigurimeve. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse nga vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, aktuarë dhe specialistë të AMF-së. Panelet e diskutimeve u fokusuan në katër tema me interes për të gjithë rregullatorët e pranishëm.

Përfaqësuesi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, ishte moderatori i temës së parë “Mbikëqyrja me Bazë Risku”. Marsela Vaska, aktuale e AMF-së prezantoi sfidat dhe eksperiencat e rregullatorëve në drejtim të vënies në zbatim të regjimeve të reja mbikëqyrëse, qasja e tregjeve ndaj kërkesave të reja, mbikëqyrja e grupeve të sigurimit, si dhe mënyrat e rritjes së bashkëpunimit për rregullatorët e këtij rajoni.

Ndër temat e tjera të trajtuara në konferencë ishin:

- *Solvency II* (“Normaliteti i ri” i mbikëqyrjes sipas *Solvency II*, eksperiencat dhe leksionet e para për mbikëqyrësit);
- Modelet e stafeve të mbikëqyrjes, sfidat dhe burimet financiare të autoriteteve;
- Produktet e sigurimeve me bazë investimet dhe krahasimi i tyre me produktet tradicionale të kursimeve - Rregullimi i produkteve komplekse PRIIPs (*Packaged Retail and Insurance-based Investment Products*) dhe i direktivës së shpërndarjes së sigurimeve që rregullon këto produkte IDD (*Insurance Distribution Directive*).

Gjatë takimit, të pranishmit ndanë eksperiencat e tyre në fushën e mbikëqyrjes së sigurimeve dhe diskutuan në lidhje me sfidat kryesore në këtë aspekt. Takimi i radhës i Iniciativës për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, pranverën e vitit 2018, do të zhvillohet në Shqipëri, nën kujdesin organizativ të Autoritetit.

—○○○—
Përfaqësuesi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, prezantoi sfidat dhe eksperiencat e rregullatorëve në drejtim të vënies në zbatim të regjimeve të reja mbikëqyrëse, qasja e tregjeve ndaj kërkesave të reja, mbikëqyrja e grupeve të sigurimit, si dhe mënyrat e rritjes së bashkëpunimit për rregullatorët e këtij rajoni.
—○○○—

Sigurimet dhe Pensionet nga një perspektivë e re: Një ndryshim i rëndësishëm

(vijon nga numri i kaluar)

Gabriel Bernardino

Kryetar

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale, EIOPA

Konferenca e 7-të vjetore e EIOPA-s

Frankfurt, 22 nëntor 2017

Programi i konferencës së këtij viti iu dedikua temës “Sigurimet dhe pensionet nga një perspektivë e re”. Duke pasqyruar zhvillimet e kohës, z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale në fjalën e hapjes theksoi se “...jetojmë në epokën e “inteligjencës artificiale” ku shkenca kompjuterike zhvillon “agjentë inteligjentë”, që do të thotë se kemi pajisje që e perceptojnë mjedisin e saj dhe ndërmarrin veprime që maksimizojnë shanset e saj për sukses për disa qëllime. Pra, si qenie njerëzore, duhet të jemi të aftë të “rifreskojmë” idetë tona, të “rishikojmë” rrugën tonë dhe të perceptojmë mjedisin tonë në mënyrë që të ndërmarrim veprime që maksimizojnë mundësinë tonë për ndërtimin e një tregu të suksesshëm sigurimesh dhe pensionesh për të mirën e shoqërisë sonë dhe qytetarëve tanë”. Në fjalën e tij z. Gabriel Bernardino preku katër tema që përfshijnë prioritetet kryesore strategjike të EIOPA-s.

(Pjesa e dytë)

Konvergjencia mbikëqyrëse dhe krijimi i një kulture të përbashkët mbikëqyrëse evropiane

Në tre vitet e ardhshme, një nga prioritetet kryesore të EIOPA-s është përmirësimi i mëtejshëm i konvergjencës mbikëqyrëse me qëllim lëvizjen drejt një kulture të përbashkët mbikëqyrëse evropiane, një kulture të bazuar në risk, e cila:

- Synon të sigurojë mbikëqyrje të fortë, por të drejtë;
- Bazohet në një qasje progresive dhe proporcionale ndaj risqeve;
- Merr parasysh se është gjithmonë më mirë të parandalosh sesa riparosh;
- Prioritizon dialogun me pjesëmarrësit e tregut në mënyrë që të kuptojnë më mirë modelet e tyre të biznesit, strategjitë dhe risqet themelore;
- Zbaton skepticizmin profesional dhe një qëndrim sfidues;
- Promovon ndërgjegjësim të hershëm dhe veprim mbikëqyrës për të mbrojtur të siguarit dhe për të zbutur ndërprerjet e mundshme në treg.

Bordi i Mbikëqyrësve të EIOPA-s miratoi broshurën që përshkruan bazën e një kulture të përbashkët mbikëqyrëse evropiane. Ajo përshkruan elementët më të rëndësishëm të mbikëqyrjes me cilësi të lartë dhe efektivitet, duke filluar nga parimet që mbështesin një kulturë të përbashkët mbikëqyrëse evropiane dhe instrumentet themelore të nevojshme. Kjo kulturë e përbashkët mbikëqyrëse mbështet zhvillimin e Manualit Mbikëqyrës të EIOPA-s që përmban praktika të mira që duhen ndjekur nga autoritetet mbikëqyrëse për të arritur mbikëqyrjen

Në tre vitet e ardhshme, një nga prioritetet kryesore të EIOPA-s është përmirësimi i mëtejshëm i konvergjencës mbikëqyrëse me qëllim lëvizjen drejt një kulture të përbashkët mbikëqyrëse evropiane, një kulture të bazuar në risk.

Gjatë vitit të parë të zbatimit të *Solvency II*, EIOPA ka identifikuar nevojën për një vëmendje të veçantë në konsistencën dhe cilësinë e raporteve të Vetë Vlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Pagueuse dhe modeleve të brendshme, praktikave për vlerësimin e përmirësuar të riskut dhe mbikëqyrjes së nën-grupit.

gjithë-evropiane, të bazuar në risk, proporcionale dhe parandaluese. Manuali trajton elementët kryesorë të kuadrit të *Solvency II* dhe ofron rekomandime, shembuj praktikë, studime të rasteve dhe tregues të riskut.

Një kulturë e përbashkët mbikëqyrëse nuk mund të krijohet në mënyrë të menjëhershme. Duke punuar së bashku, hap pas hapi, duke u fokusuar dhe duke sfiduar njëri-tjetrin gjatë rrugës, ne mund të ndërtojmë një kulturë mbikëqyrëse të fortë dhe të drejtë që promovon mbrojtjen e konsumatorit dhe rrit stabilitetin e sistemit financiar për të mirën e biznesit, ekonomisë dhe shtetasve të Evropës.

Për shkak të tregut të brendshëm dhe aktiviteteve ndërkufitare, cilësia e mbikëqyrjes kombëtare nuk është më vetëm një çështje kombëtare, por një çështje evropiane. Mbikëqyrja e përditshme, duke përfshirë përgjegjësinë për monitorimin dhe sigurimin e funksionimit të duhur të kompanive të sigurimeve në Bashkimin Evropian, qëndron tek autoritetet kombëtare mbikëqyrëse. Axhenda e konvergjencës mbikëqyrëse të EIOPA-s përqendrohet në ndërtimin e standardeve dhe interpretimeve të përbashkëta, në shfrytëzimin e të dhënave për vlerësimin e riskut dhe qëllimet mbikëqyrëse, në monitorimin e standardeve të përbashkëta dhe në sfidimin dhe mbështetjen e autoriteteve kombëtare kompetente.

EIOPA po shfrytëzon instrumente të BE-së dhe si edhe instrumente ndërkufitare për të zbuluar dhe zbutur risqet. Për shembull, kemi akses nëpërmjet një depoje qendrore të dhënash për të gjitha raportimet mbikëqyrëse të ndërmarrjeve dhe grupeve individuale. Kjo lejon që EIOPA të analizojë dhe vlerësojë risqet e tregjeve kombëtare të sigurimeve nga një perspektivë evropiane, por gjithashtu të shtojë vlerën dhe efikasitetin në mbikëqyrjen kombëtare.

Si anëtare e kolegjeve të mbikëqyrësve, EIOPA gjithashtu merr pjesë në mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të grupeve ndërkufitare. Tregu evropian i sigurimeve dominohet nga më shumë se 90 grupe sigurimi ndërkufitare, të cilat selitë qendrore i kanë në Zonën Ekonomike Evropiane. Gjatë vitit të parë të zbatimit të *Solvency II*, EIOPA ka identifikuar nevojën për një vëmendje të veçantë në konsistencën dhe cilësinë e raporteve të Vetë Vlerësimit të Riskut dhe Aftësisë Pagueuse dhe modeleve të brendshme, praktikave për vlerësimin e përmirësuar të riskut dhe mbikëqyrjes së nën-grupit.

Si mjet shtesë, EIOPA përdor kritikën e kolegëve për të marrë një pasqyrë se si mbikëqyrësit kombëtarë zbatojnë parimin e proporcionalitetit, për shembull kur mbikëqyrin funksionet kryesore të ndërmarrjeve. Këto rishikime do të rezultojnë në rekomandime konkrete për t'ju adresuar çështjeve të identifikuara dhe për të zhvilluar praktikën më të mira.

Për t'ju adresuar çështjeve të pashmangshme, ku identifikohen risqet ndërkufitare që vijnë degëzimin ose lirinë për të ofruar shërbime, EIOPA ka zhvilluar të ashtuquajturat platforma bashkëpunimi. Disa platforma janë krijuar



Si rezultat i këtyre angazhimeve dypalëshe, EIOPA po përditëson në përputhje me rrethanat vlerësimin e riskut në treg dhe nivelin e mbikëqyrjes, duke ofruar reagime të pavarura dhe sfiduese, duke dhënë rekomandime për përmirësime dhe propozuar masa për ndjekje të mëtejshme.



gjatë vitit 2017, me ndikim të dukshëm në bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare mbikëqyrëse dhe veprimeve të koordinuara nga autoriteti mbikëqyrës vendas ku u zbuluan shqetësime mbikëqyrëse të pashmangshme.

Bashkëpunimi në rritje ka përshpejtuar procesin e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve në treg me ndikim të rëndësishëm në autoritetet vendase dhe ato pritëse. Për autoritetin vendas, disa nga firmat që ofrojnë shërbime kanë vepruar “nën radar”, firma më të vogla pa ndikim të drejtpërdrejtë në tregjet e tyre. Tërheqja e vëmendjes ndaj risqeve kudo në BE dhe pasojat e mundshme që ato kanë për autoritetin vendas në shumë raste ka çuar në një mbikëqyrje direkte të intensifikuar dhe një identifikim më të mirë të risqeve që vijnë nga tregjet pritëse.

Për autoritetet pritëse, platforma e bashkëpunimit ka dhënë mundësinë për të ngritur shqetësime për mbrojtjen e të siguruarve në juridiksionet e tyre. Në vend që të informohet kur hiqet një licencë ose një kompani është në proces likuidimi, autoriteti pritës informohet shumë më herët dhe më mirë.

Ky proces mund të drejtohet dhe mbështetet vetëm nga një autoritet që merr në konsideratë interesat e të gjithë të siguruarve të BE-së dhe që drejton veprimin e tij duke pasur këtë objektiv. Ndërsa zhvillimet shpalosen dhe nevoja për veprim të menjëhershëm mbikëqyrës rritet, presioni brenda platformës së bashkëpunimit rritet dhe kërkon shumë koordinim dhe komunikim nga ana e EIOPA-s së bashku me të gjithë mbikëqyrësit e përfshirë, për të drejtuar zhvillimet në drejtimin e duhur. Rezultatet e para të platformave të bashkëpunimit në vitin 2017 kanë qenë shumë inkurajuese dhe ky mjet është përqafuar nga komuniteti mbikëqyrës si një shtesë e mirëpritur në rutinë e mjeteve të konvergjencës mbikëqyrëse.

Përveç mjeteve të BE-së dhe ato ndërkufitare, EIOPA shfrytëzon aktivisht angazhimet dypalëshe me autoritetet kombëtare mbikëqyrëse. Këto janë të përshtatura për specifikat kombëtare pas diagnozës dhe analizës së tregjeve kombëtare dhe aktiviteteve ndërkufitare përkatëse. Si rezultat i këtyre angazhimeve dypalëshe, EIOPA po përditëson në përputhje me rrethanat vlerësimin e riskut në treg dhe nivelin e mbikëqyrjes, duke ofruar reagime të pavarura dhe sfiduese, duke dhënë rekomandime për përmirësime dhe propozuar masa për ndjekje të mëtejshme. Ndjekje specifike të këtyre angazhimeve dypalëshe kanë qenë, për shembull, shqyrtimet e detajuara të bilancit të sektorit të sigurimeve të kryera në Rumani dhe Bullgari.

EIOPA ka luajtur një rol të rëndësishëm në këto rishikime bilanci, duke qenë një anëtare aktive e komitetit drejtues të ushtrimeve dhe duke u fokusuar në veprimet mbikëqyrëse për të ndjekur konkluzionet. Një nga elementët kryesorë të kulturës së përbashkët mbikëqyrëse është konkludimi si mbikëqyrës, për të ndërmarrë veprime dhe për të kontrolluar se kur shfaqen çështjet dhe EIOPA po merr rol drejtues në këtë aspekt. Ndikimet fillestare të shqyrtimeve, ku janë të dukshme disa efekte të menjëhershme në firmat dhe praktikatat e tregut janë të dukshme, janë ndjekur nga bashkëpunimi intensiv i vazhdueshëm me

—○○○—
Theksi në arritjen e konvergencës mbikëqyrëse pasqyrohet gjithashtu edhe në propozimin e Komisionit Evropian për shqyrtimin e Rregullores së EIOPA-s.

—○○○—

autoritetet lokale mbikëqyrëse.

Theksi në arritjen e konvergencës mbikëqyrëse pasqyrohet gjithashtu edhe në propozimin e Komisionit Evropian për shqyrtimin e Rregullores së EIOPA-s. Ne e mirëpresim propozimin dhe besojmë se mandati më i fortë i EIOPA-s për të siguruar konvergencë në praktikat mbikëqyrëse nëpërmjet zhvillimit të Planeve Strategjike Mbikëqyrëse dhe fuqizimit të ndërmarrjes së vlerësimeve të pavarura të modeleve të brendshme, janë hapa të qartë në drejtimin e duhur.

Megjithatë, ne konsiderojmë se ka ende çështje që meritojnë një rregullim të mirë. Më lejoni të përmend vetëm dy fusha:

Së pari, Rregullorja e EIOPA-s duhet të forcohet me një mandat për të vepruar në mënyrë më të thellë kur zbulon sinjale për risqet e dështimeve ndërkufitare. Për të lejuar veprimtarinë e EIOPA-n në mënyrë parandaluese, autoritetet kombëtare mbikëqyrëse duhet të jenë të detyruara të njoftojnë EIOPA-n sa më shpejt në rast se kompanitë e sigurimeve pësojnë përkeqësim të kushteve financiare me efekte të mundshme ndërkufitare.

Së dyti, duhet të forcohet gjithashtu roli i EIOPA-s në lidhje me pavarësinë mbikëqyrëse dhe konfliktin e interesave. Këto parime themelore mbikëqyrëse kanë fituar edhe më shumë rëndësi në *Solvency II*, për shkak të shkallës së gjykitimit mbikëqyrës të nevojshëm në zbatimin e një regjimi të bazuar në risk. Është thelbësore që mbikëqyrësit kombëtarë janë funksionalisht të pavarur dhe se janë përgjegjës për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre. Pavarësia operationale, transparenca dhe përgjegjshmëria e mbikëqyrësve kombëtarë duhet të përforcohet me krijimin e një kornize të fortë evropiane dhe një roli të qartë për EIOPA-n në vlerësimin e zbatimit të saj.

Së fundi, mirëpresim propozimin për të përfshirë në mandatin e EIOPA-s qëndrueshmërinë dhe inovacionin teknologjik, pra InsurTech-in. Autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse kanë një rol kryesor për të siguruar se konsumatorët mund të përfitojnë nga inovacioni, ndërkohë vazhdojnë të jenë të mbrojtur siç duhet.

Bosnje-Hercegovinë

www.xprimm.com

Për 9-mujorin e vitit 2017, kompanitë e sigurimeve në Bosnje-Hercegovinë raportuan të ardhura prej 518.2 milionë marka (BAM monedha lokale) ose rreth 265 milionë euro, me një rritje prej 8.1% nga e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Sektori i Jo-Jetës mbetet mbizotërues, me 80.3% të totalit, 212.8 milionë euro, me një rritje prej 7.6%, ndërkohë që sektori i Jetës kontribuoi për pjesën tjetër të të ardhurave, me një rritje 9.9%, krahasuar me 9-mujorin e vitit të kaluar.

Çeki

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Shoqatës së Sigurimeve të Çekisë, deri në fund të shtatorit të këtij viti, tregu i sigurimeve në Çeki gjeneroi 92.9 miliardë koruna (CZK monedha lokale) ose rreth 3.6 miliardë euro, me një rritje prej 3.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Segmenti i sigurimeve të Jetës shënoi një rënie të lehtë me 0.2%, duke sjellë 32.5 miliardë CZK të ardhura, ndërkohë që sektori i Jo-Jetës u rrit me 6.1%, me 60.4 miliardë CZK. Dy segmentet e sigurimit motorik (MTPL dhe Kasko) gjeneruan së bashku rreth 1 të tretën e të gjitha të ardhurave (30 miliardë CZK), ndjekur nga sigurimet për industrinë dhe bizneset, me 15% të totalit të tregut dhe sigurimet për pronën me rreth 9%.

Greqi

www.xprimm.com

Siguruesit në Greqi raportuan të ardhura prej 2.8 miliardë euro në fund të shtatorit të këtij viti, me një rritje të lehtë prej 0.26% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Segmenti i Jetës shënoi rënie në masën 1.4%, duke sjellë 1.37 miliardë euro të ardhura. Në anën tjetër, sektori i Jo-Jetës u rrit me 1.91%, duke sjellë 1.43 miliardë euro të ardhura.

Hungari

www.xprimm.com

Siguruesit në Hungari e mbyllën 9-mujorin e këtij viti me një rritje në masën 6.6%, duke gjeneruar 711.2 miliardë forinta (HUF monedha lokale) ose 2.3 miliardë euro, sipas të dhënave më të fundit të Bankës Qendrore të Hungarisë. Sigurimi i Jetës u rrit me 3.8%, ndërsa ai i Jo-Jetës me 8.3%. Sa i përket dëmeve të paguara, deri në fund të shtatorit janë paguar 270.3 miliardë forinta për kontratat e Jetës, si edhe 166.6 miliardë forinta në segmentin e Jo-Jetës.

Mali i Zi

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi, siguruesit e mbyllën 9-mujorin e këtij viti me 61.2 milionë euro të ardhura, me një rritje prej 3.2%. Sigurimi i Jetës shënoi rritje gjatë kësaj periudhe, duke gjeneruar rreth 10 milionë euro të ardhura. Në anën tjetër, sigurimi i pronës shënoi rritjen më të madhe për segmentin e Jo-Jetës, në masën 8.6%.

Maqedoni

www.xprimm.com

Siguruesit në Maqedoni raportuan të ardhura prej 6.8 miliardë denarë (MKD monedha lokale) ose 110.6 milionë euro, me një rritje prej 2.7% krahasuar me 9-mujorin e vitit të kaluar, sipas shifrave të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve. Sigurimet e Jo-Jetës mbeten dominuese në treg, me 86%, ndërsa pjesa tjetër i takon segmentit të Jetës. Gjithashtu përsa i përket kategorive të sigurimit, mbizotëron klasa MTPL, me 45.6% të totalit, e ndjekur nga sigurimi i pronës 16.8%, Kasko 8.5%, etj.

Poloni

www.xprimm.com

Megjithë rritjen e fortë të sigurimit motorik, siguruesit polakë e mbyllën 9-mujorin e këtij viti me një rënie prej 2%, duke gjeneruar 9.44 miliardë euro të ardhura. Kjo për shkak të rënies së fortë të sigurimeve të Jetës, në masën 16%, të cilat sollën 4.13 miliardë euro. Në anën tjetër, segmenti i Jo-Jetës gjeneroi 5.3 miliardë euro të ardhura, me një rritje prej 12% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi motorik dhe kryesisht MTPL shënoi rritjen më të madhe, me 30%.

Serbi

www.xprimm.com

Të dhënat e 9-mujorit të publikuara nga siguruesit në Serbi flasin për një rritje prej 6.3% të tregut, që gjeneroi të ardhura në vlerën e 70.9 miliardë dinarëve (RSD monedha lokale) ose 594.1 milionë euro, më shumë se gjysma e tyre nga sigurimi motorik. Segmenti i Jetës shënoi një rritje të lehtë, në masën 3%, me të ardhura prej rreth 133.6 milionë euro. Sa i përket sektorit të Jo-Jetës, kontributin kryesor në rritjen e tregut e ka sigurimi MTPL.

Slloveni

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Slloveni ka shënuar një rritje prej 6.6% në bazë të të ardhurave të 9-mujorit, duke sjellë 1.67 miliardë euro të ardhura, sipas të dhënave të Shoqatës së Sigurimeve në këtë vend. Të ardhurat nga segmenti Jetë u rritën me 10.1%, në masën 486 milionë euro, ndërkohë që sektori i Jo-Jetës gjeneroi 1.18 miliardë euro të ardhura, me një rritje prej 5.2%. Gjithashtu u shënuar një rritje e vlerës së dëmeve të paguara në masën 9.8%, për një total prej 1.1 miliardë euro për 9-mujorin.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al